



AGJENCIA KADASTRALE E  
KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES-KOSOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA

№/Bc: 01/2596/20

№i fq./Dr.str.: \_\_\_\_\_

Data/Datum: 16.09.2020

PRISHTINE-PRISTINA



ODA E PËRMBARUEVE  
PRIVAT TË KOSOVËS

ODA E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVES  
KOMORA PRIVATNIH IZVRSHITELJA KOSOVA

Data: 16 / 09 / 2020 Nr: 387 / 2020

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**NË MES**

**AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS**

**DHE**

**ODËS SË PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS**

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm si "AKK") dhe

Oda e Përmbauesve Privat të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "OPK").

Në tekstin e mëtejshëm të referuara bashkërisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala"

## **Neni 1 Qëllimi**

1. Ky memorandum ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit në mes palëve nënshkruese për qasjen në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm si "RDPP") përmes ueb shërbimeve.
2. AKK dhe OPK do të krijojnë Procedura Standarde të Operimit për shkëmbimin e shënimeve ku edhe do të definohet lloji i të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivelin teknik të shkëmbimit të informatave si dhe çmimi i pagesës për ofrimin e këtyre shërbimeve.

## **Neni 2 Përdorimi i të dhënave**

1. Përdorimi i të dhënave do të mundësohet në nivel leximi dhe printimi përmes ueb shërbimit dhe do të jetë i qasshëm vetëm nga përdorues të autorizuar, me mundësi kërkimi për njësi kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës) dhe për person.
2. Të dhënat që do t'i shfrytëzojnë zyrat e përmbauesve janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj marrëveshje dhe përmbushjes së obligimeve sipas legjislacionit në fuqi, vetëm për qëllime zyrtare.
3. Përdorimi i këtyre të dhënave për qëllime tjera konsiderohet si keqpërdorim dhe si i tillë do të sanksionohet sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

## **Neni 3 Detyrimet e AKK-së**

1. AKK do t'i siguroj qasje për lexim dhe printim të informatave me pagesë për të gjithë personat e autorizuar, bazuar në nenin 24 dhe 26, të Ligjit Nr.04/L-013 për Kadastër, nenin 17, paragrafi 1 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, neni 32 i Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin 05/L-007 dhe Ligjin Nr. 06/L-021, bazuar në tarifatat e përcaktuara me udhëzim administrativ.
2. AKK do t'i ofroj të dhënat nga RDPP përmes Ueb shërbimeve duke shfrytëzuar bazën elektronike të sistemeve digjitale.
3. AKK do të caktoj një zyrtar, i cili do të jetë pikë kontakti mes palëve nënshkruese të këtij memorandumit.
4. AKK do të mbajë trajnim për zyrtarët të cilët do të kenë qasje në RDPP përmes ueb shërbimeve.
5. AKK, nxjerrë raporte për shërbimet e dhëna (javore, mujore, vjetore) sipas kërkesës.

6. Fatura, për shërbimet e dhëna do të lëshohet në fund të çdo muaji kalendarik dhe mund të dërgohet në forme elektronike ose të merret në letër në AKK.

7. AKK do të hartoj dokumentin "Marrëveshja e nivelit të shërbimit" si udhëzues për mënyrën e përdorimit të ueb shërbimeve si dhe llojet e shërbimeve që do të ofrohen.

8. AKK siguron që të dhënat që i ofron do të jenë të përditësuara dhe të qasshme në çdo kohë.

#### **Neni 4 Detyrimet e OPK-së**

1. OPK i jep AKK-së listën e personave të autorizuar të cilët do të kenë qasje në Regjistrin e të dhënave kadastrale.

2. OPK obligohet që të kryejë përgatitjet teknike të nevojshme për qasje në RDPP përmes ueb shërbimit.

3. OPK merr përgjegjësi të caktojë një zyrtar kontaktues sa i përket kërkesave për hapjen/mbylljen e llogarive të përdoruesve, mbikëqyrjen e sigurisë dhe çështjeve tjera të lidhura me qasjen dhe përdorimin e të dhënave përmes ueb shërbimeve nga RDPP.

4. Personat e autorizuar për qasje në RDPP përmes ueb shërbimeve, janë të obliguar që me rastin e lëshimit të një Urdhri Përmbartues në sistem të evidentojnë shënimin "**për këtë njësi kadastrale është nxjerrë Konkluzioni apo Aktvendimi P. P. xx/2020**", në rubrikën e përcaktuar nga AKK.

5. Personi i autorizuar obligohet të ruaj fshehtësinë dhe të mbajë të sigurt të dhënat e marra-shikuara nga RDPP.

6. Personi i autorizuar obligohet që të mbajë evidencën e raporteve të punës në sistemin e AKK.

7. Afati i pagesës së çdo fature është pesëmbëdhjetë ditë nga data e lëshimit.

8. Në rast të moskryerjes së pagesës, atëherë përfaqësuesit të autorizuar që merr shërbime i ndalet qasja derisa të kryej pagesën dhe sipas nevojës lënda do të procedohet për përmbartim.

#### **Neni 5 Zbatimi**

1. Palët pajtohen se do të kujdesën për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj marrëveshje.

2. Modalitetet e ofrimit të të dhëna do të përcaktohen më në detaje në mes AKK-së dhe OPK pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje duke marre parasysh kërkesat e të dy palëve për sigurinë e parandalimit të keqpërdorimit të të dhënave.

**Neni 6**  
**Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare**

1. Ky Memorandum lidhet në afat të pacaktuar.
2. Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë nga të dyja palët, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.
3. Palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë memorandum si parashihet në të. Mosmarrëveshjet eventuale zgjidhen me mirëkuptim.
4. Memorandumi i Bashkëpunimit është i shkruar në gjuhën shqipe, në dy kopje, nga një për secilën palë dhe hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Palët nënshkruese**

**Avni Ahmeti**  
  
Drejtore Ekzekutive  
Agjencia Kadastrale e Kosovës



**Arben Gashi**  
  
Kryetar  
Odës së Përmbauesve Privat të Kosovës





AGJENCIA KADASTRALE E  
KOSOVËS



## PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT NË SISTEMIN E REGJISTRIT PËR TË DREJTAT NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR ODËN E PËRMBARUESVE PRIVATË TË KOSOVËS

### I. HYRJE

Ky dokument paraqet Procedurën Standarde të Operimit që përmbaruesit, përmes Odës së Përmbaruesve, të kenë qasje në Sistemin e Regjistrimit për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme. Ky dokument është pjesë përbërëse e Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës.

### II. QËLLIMI

Qëllimi i këtij dokumenti është paraqitja specifike e procedurave standarde se si përmbaruesit mund të kyçen dhe ta përdorin sistemin në fjalë si dhe mënyra e realizimit të pagesave.

### III. FUSHËVEPRIMI

Fushëveprimi i këtij dokumenti mbulon vetëm pjesën e sistemit për të cilën përmbaruesve u ofrohet qasje.

### IV. PËRKUFIZIME

Për qëllime të kuptimit dhe interpretimit më të lehtë të veprimeve të caktuara, fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimet që janë ofruar në Memorandumin në fjalë. Nëse ndërkohë paraqitet nevoja për interpretim të ndonjë fjale, shprehje, ose veprimi të caktuar, e njëjta do të interpretohet sipas praktikave standarde të Teknologjisë Informative.

### V. PËRGJEGJËSIA

1. Oda e Përmbaruesve ka të drejtën që në emër të secilit përmbarues që është anëtar i Odës të ia paraqes AKK-së të gjitha ndryshimet në listën e përmbaruesve – anëtarëve të Odës, duke përfshirë lejimin apo ndërprerjen e qasjes për secilin përmbarues që është anëtarësuar në Odë, dhe Oda e informon AKK-në për ndryshimet në listën e përmbaruesve-anëtarë të Odës.
2. Oda, sipas kërkesës së AKK-së ose me iniciativën e saj, mund t'ia kufizojë pjesërisht ose bllokujë tërësisht qasjen përmbaruesit që konsiderohet se i ka tejkaluar, shkelur ose ka kryer ndonjë veprim që e dëmton sistemin e AKK-së ose reputacionin e Odës si dhe në rast të mos përmbushjes së obligimeve të pagesës.

3. Secili përmbarues është përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e saj/tij gjatë përdorimit të këtij sistemi.
4. Dëmet e shkaktuara nga përmbaruesi gjatë përdorimit të këtij sistemi, përveç përgjegjësisë disiplinore dhe administrative, nuk e përjashtojnë edhe përgjegjësinë materiale, dhe dëmet eventuale në asnjë mënyrë nuk konsiderohen si përgjegjësi për Odën si institucion.

## VI. PROCEDURA STANDARDE

1. Në zyrën e çdo përmbaruesi duhet të ketë lidhje interneti.
2. Në shfletues të internetit (browser) duhet të shkruhet faqja e adresës për <https://sikt-online.rks-gov.net/online> dhe nga këtu duke përdorur kredencialet e ofruara për secilin përmbarues bëhet kyçja në sistem.
3. Kërkesa për ofrimin e qasjes për shfrytëzuesit e rinj, çkyçjen nga sistemi të shfrytëzuesve ekzistues, kufizimin e qasjes për shfrytëzuesit ekzistues, ose resetim të fjalëkalimit, duhet të dërgohet nga Oda tek AKK-ja.

## VII. SIGURIA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

1. AKK-ja dhe përmbaruesi kujdesen së bashku për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave të sistemit, ashtu si edhe për privatësinë e të dhënave të subjekteve të regjistruara në sistem.
2. Keqpërdorimi ose përdorimi i panevojshëm i të dhënave të sistemit, i nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Kosovës, si dhe kufizimeve të këtij dokumenti.

## VIII. FATURIMI DHE PAGESA E PRODUKTEVE

1. Tarifat për shërbimin e ofruar përmes web shërbimeve janë të përcaktuara me udhëzim administrativ.
2. Faturimi i produkteve të marra do të bëhet në fund të çdo muaji kalendarik.
3. Fatura dhe raporti do t'i dërgohet Odës së Përmbaruesve përmes email-it, ose do të tërhiqet nga zyrtari i autorizuar prej tij,
4. Pagesa duhet të kryhet në afatin prej njëzet (20) ditësh të muajit vijues.
5. Nëse nuk bëhet pagesa e faturës sipas afatit të përcaktuar, përmbaruesit do t'i ndërpritet qasja dhe lënda do të procedohet në përmbarim

Për Odën e Përmbaruesve të Kosovës

Kryetari i Odës  
Arben Gashi

Datë:  
16.10.2020



Për Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Kryeshefi ekzekutiv  
Avni Ahmeti

Datë:  
16.10.2020

